

**BASHKIA KURBIN**

Drejtuar: Operatorit ekonomik “MURATI D” SHPK, Adresa: Tirane, Rruga Kavajes, Ish- Kombinati Ushqimor, Godine 1- kateshe.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” Mallra (Prokurim me mjete elektronike).

Numri i procedurës / referenca: REF-85772-10-30-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjente, Bashkia Kurbin”.

Fondi limit: 2,077,800 (dy milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.90, datë 06.11.2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar ne kosto   
oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “GET klin” SHPK, me numër NIPTI L82420502U.  
Vlera e ofertuar: 0 (zero) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “MURATI D” SHPK, me numër NIPTI K42003004T.  
Vlera e ofertuar: 955,405 (nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e pesë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik “BESIM KAMBER” PF, me numër NIPTI L42103023G.  
Vlera e ofertuar: 1,397,000 (një milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK, me numër NIPTI K22218003V.  
Vlera e ofertuar: 1,455,000 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- I. Operatori ekonomik “GET klin” SHPK, me numër NIPTI L82420502U.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit ..., si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:, “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

- Operatori ekonomik “GET klin” SHPK, nuk ka paraqitur mostrat ditën e hapjes së procedurës, kriter ky i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.
- Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimit elektronik K.V.O konstatoi se operatori ekonomik “GET klin” Shpk, përveç Vërtetim për Pagim Detyrimesh, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion tjetër.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “MURATI D” SHPK, me adresë: Tirane, Rruga Kavajes, Ish- Kombinati Ushqimor, Godine 1- kateshe, se oferta e

paraqitur me vlerë totale prej: 955,405 (nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.